

FROSKA SAPUNXHIEVA

FLURIM ZULFIJA

VESELINKA MAXHAROVA

# ARSIMI MUZIKOR

## PËR KLASËN VII



ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

FROSKA SAPUNXHIEVA      FLURIM ZULFIJA  
VESELINKA MAXHAROVA

# **ARSIMI MUZIKOR**

**PËR KLASËN VII**  
**ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR**



**Autorë:**

Mr. Froska Sapunxhieva  
Mr. Flurim Zulfija  
Veselinka Maxharova

**Recensentë:**

Mr. Zhana Dimçevska – kryetare  
Suzana Kostovska - anëtare  
Natasha Dimovska - anëtare

**Titulli i botimit original:**

МУЗИЧКО ОБРАЗОВАНИЕ ЗА VII ОДДЕЛЕНИЕ  
ДЕВЕТГОДИШНО ОСНОВНО ОБРАЗОВАНИЕ

**Botues:**

Ministria për Arsim dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut  
Rr. "Shën Kirli dhe Metodi", nr. 54, 1000 Shkup

**Përktheu nga gjuha maqedone:**  
Kujtim Ramadani

**Lektor:**

Arbana Qormemeti

**Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe:**  
Dardan Braimi

**Radhitja kompjuterike:**  
Arbëria Design (Afrim Bulica)

**Përpunimi kompjuterik dhe dizajni grafik:**  
Veselinka Maxharova

**Vendi dhe viti i botimit:**  
Shkup, 2022

Me vendim të Komisionit nacional për tekste shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm  
pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut me nr.  
26-1202/1 të datës 30.07.2020 lejohet përdorimi i këtij teksti mësimor.

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

78(075.2)

SAPUNXHIEVA, Froska

Arsimi muzikor [Електронски извор] : për klasën VII : arsimi fillor nëntëvjeçar / Froska Sapunxhieva, Flurim Zulfija, Veselinka Maxharova ; përktheu nga gjuha maqedone: Kujtim Ramadani. - Текст во ПДФ формат, содржи 88 стр., илустр. - Shkup : Ministria për Arsim dhe Shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022

Начин на пристапување (URL):

[https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Muzicko\\_7\\_albanski.pdf](https://www.e-ucebnici.mon.gov.mk/pdf/Muzicko_7_albanski.pdf). - Превод на делото: Музичко образование за 7 одделение деветгодишно основно образование / Фроска Сапунчиева, Флурим Зулфија, Веселинка Маџарова. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 19.08.2022

ISBN 978-608-273-086-8

1. Zulfija, Flurim [автор] 2. Maxharova, Veselinka [автор]  
а) Музичко образование -- Учебници, основно образование

COBISS.MK-ID 58001157

## ANEKDOTA




### BAST

Wolfgang Amadeus Mozart, përveç se ka qenë një kompozitor gjenial, ishte edhe një njeri i mirë me karakter tejet gazmor dhe gjithmonë i gatshëm për shaka..

Një herë, (në një situatë) ndërsa ishte në shoqërinë e miqve, ai vuri bast se mund të luante një akord që askush tjetër në botë nuk mund ta luante.

Mozart shkroi një akord të tillë që përbëhej nga nëntë tone prej të cilave: katër tone ishin në anën e majtë të tastierës, katër në anën e djathtë dhe një në mes, aq larg nga tonet e tjera sa ishte e pamundur të luhej. Kur miqtë e tij e panë akordin e shkruar, u bindën se ishte e pamundur të luante një akord të tillë dhe ranë dakord të bënин bast.

Në atë moment, Mozart u ul i humtur në karrigen e pianos dhe luajti katër tone në anën e majtë të tastierës me dorën e tij të majtë, katër tone në anën e djathtë të tastierës me dorën e tij të djathtë dhe luajti tonin e vëtmuar në mes të tastierës me hundën e tij! Kështu Mozart e mori bastin



### MENDJE OSE PARA

Ludvig van Bethoven ishte i vetëdijshëm përgjenialitetin e tij dhe ishte person i respektuar dhe i vlerësuar në vendin e tij dhe jashtë tij. Vëllai i Ludvigut ishte gjithmonë i zënë me gjëra të ndryshme, por nuk mund të bënte vetëm një gjë dhe t'ia dilte mbanë. Por vëllai i tij befas u pasurua duke u përfshirë në aktivitete të paligjshme dhe duke u mburrur për pasurinë e tij, ai i dërgoi Ludvigut një kartëvizitë ku shkruhej: "Johan van Betoven, agjent për pasuri të paluajtshme". Për këtë Ludvig u përgjigj: "Ludvig van Betoven, agjent përmendje".

**KËNAQUNI NË MUZIKËN DUKE MËSUAR PËR ATË!**



## ДРУГАРСТВО (ПО СЛУХ) / MIQËSIA (ME DËGJIM)

Muzika dhe teksti: Veselinka Maxharova

И - ма не - што у - ба - во во ду - ша што ти спи - е.

Ба -raj го, раз - бу - ди го, не - ка не спи - е.

Дру-гар-ство е знај да се по -мо - гне дру - га - рот те пра - ви по сре- ќен зар не?

Нај ди си дру-гар- че и де-ли се чу-вај го дру-гар-ство-то не-ка жи-ве-е. не-ка жи-ве-е.

Има нешто убаво  
в срце што се крие.  
Барај го, пронајди го,  
нека живее!

Рефрен: Другарство е знај да се помогне  
другарот те прави посреќен зар не?  
Најди си другарче и дели сè  
чувај го дружеството нека живее.



Muzika: Johan Sebastijan Bah

### Во природата

Колку сакам птичји звук,  
штом ќе чујам глас од славеј мал.

Сакам шуми, реки, поле,  
сакам вечен живот волен.

Сакам песни, птици в лет,  
јас го сакам овој свет.

### Ilk baharda

Severim ben  
kuş sesi.  
Bülbül sesini  
duyunca ben.

Orman ister  
nehir vadı.  
Severim  
sonsuz hayatı.

Şarkı sever  
uçan kuşu.  
Severim ben  
Güzel dünyayı

### Në natyrë

Dua zogjt kur cicërojn'  
kur dëgjoj t'voglin trumcak.

Dua pyje, lumej, fusha,  
gjithmon dua jetën e dashur.

Dua këngën t'zogjve n'fluturim,  
sa e dua unë kët bot'

### Ах, што волим

Ах, што волим песме звук,  
волим благе ноћи тихи мук.

Волим шуму, реку, поље,  
ја сам увек добре воље.

Волим сунце, волим гај,  
Волим драги родни крај.

Волим игре, шале све,  
ал' не волим људе, људе зле.

Волим оца, мајку милу,  
доброг брата, сестру чилу.

Волим цвће, птица лет,  
Волим, волим читав свет.



## NOTA KATËRSHE ME PIKË



Kur shkruajmë një pikë pranë kokës së notës, në anën e djathtë, atëherë kohëzgjatja e notës zgjatet për gjysmën e vlerës së saj.

Një çerek note me pikë zgjat një goditje e gjysmë.



Një çerek note zgjat një goditje, dhe vazhdimi i saj me pikë vlen një të tetën që zgjat gjysmë goditje.

Ushtrimi nr. 1

Ushtrimi nr. 2

Ushtrimi nr. 3

Ushtrimi nr. 4

### Detyra

- ♦ Ushimet numër 1, 2 dhe 3 luani në instrumente ritmike për fëmijë.



## ДЕТСКА ЖЕЛБА (ПО СЛУХ) / DËSHIRA E FËMIJËVE (ME DËGJIM)



Muzika dhe teksti: Froska Sapunxhieva

За си - те де - ца ни - е пе - е - ме

сре - ка и ра - дос т се - е - ме, за мир во све - тот да наз-дра-ви-ме,

за - ед-но да про- слави - ме. Со же л - ба на - ша сил - на, да и - ма ми-рен

сон со пес - на о - ро шир - но да ек - не си -лен звон. Со звон.

Со радост, љубов да порачаме  
гладни и жедни да немаме,  
за добри дела да се фатиме,  
детството да го вратиме.


Рефрен: Со желба наша силна,  
да има мирен сон  
со песна оро ширно  
да екне силен звон.





## NDARJA E INSTRUMENTEVE POPULLORE

Secili popull ka instrumentet e veta popullore me karakteristika specifike të përpunimit. Instrumentet popullore e kanë origjinën nga instrumentet primitive, të cilat fillimisht ishin bërë nga kockat e kafshëve, druri, lëvorja e frutave dhe gurët. Me zhvillimin e njeriut dhe instrumenteve, ato filluan të marrin formë dhe të përmirësohen vazhdimesht dhe për atë dëshmojnë pamjet e gjetura brenda pyramidave.



### NDARJA E INSTRUMENTEVE POPULLORE MUZIKORE

#### INSTRUMENTE MUZIKORE FRYMORE



Në grupin e instrumenteve frysore bëjnë pjesë:

- ◆ gjajdja
- ◆ zurla
- ◆ kavalli
- ◆ fyelli
- ◆ zamarja
- ◆ kavalli i dyfishtë

Tingulli fitohet duke fryrë në instrument.

#### INSTRUMENTE POPULLORE ME TELA



Në grupin e instrumenteve popullore me tela bëjnë pjesë:

- ◆ tambura
- ◆ kemane
- ◆ uti
- ◆ kanon
- ◆ çiftelia
- ◆ lahuta
- ◆ sazja

Tingulli fitohet kur telat shtypen me gishta dhe telat têrhiqen me dorën tjetër.

#### INSTRUMENTE POPULLORE ME GODITJE



Në grupin e instrumenteve popullore me goditje bëjnë pjesë:

- ◆ daullja
- ◆ tupani i vogël
- ◆ dajrja

Tingulli fitohet duke goditur instrumentin.

Instrumentet popullore në të kaluarën por edhe sot përpunohen nga materiale natyrore që njerëzit i gjenin në rrethinë e tyre të afërt.

Shumica e instrumenteve popullore janë të njëjta te kombe të ndryshëm, por me emra të ndryshëm ose me ndryshime të vogla në prodhimin e instrumentit. Për shembull, zurlën turqit e quajnë zurna, por do ta gjejmë edhe me emra të tjera si surla, surna, surli dhe emra të tjera të ngjashëm të instrumentit.

## ТАТКОВИНО (ПО СЛУХ) / ATDHEU (МЕ ДЁГЈИМ)



Muzika dhe teksti: Pavlinka Velanoska


4

Тат - ко - ви - но мо - ја нај - ми - ла во  
ср - це те но - сам се - ко - гаш ре - ки, по - ли - ња,  
пла - ни - ни у - ба - ви - наraj - ска при - про - да.  
Бej се зна - ме ви - оп - но, де - нес праз - ник  
сла - ви - ме на мо - ја - та тат - ко - ви - на  
зем - ja на - ша нај - ми - ла



## TEMPO

Tempo është fjalë italiane që do të thotë shpejtësi. Shpejtësia me të cilën interpretohen veprat muzikore quhet **tempo**.



Shumica e shprehjeve muzikore janë në gjuhën italiane dhe si të tilla përdoren në të gjithë botën. Prandaj me të drejtë mund të themi se muzika dhe shkrimi muzikor, është gjuhë universale për të gjithë popujt.

Tempo shënohet mbi pentagramin pas çelësit të violinës, në fillim të çdo kompozimi muzikor. Gjatë veprës muzikore mund të ketë ndryshime të tempos.

Për të përcaktuar shpejtësinë e të kënduarit dhe të luajturit tonë, duhet të përdorim metronom.

### *Shembuj për të dëgjuar (fragmente):*

„Fluturimi i brumbullit“ – N. R. Korsakov

„Marshimi turk“ – V. A. Mozart

„Adaxho“ – T. Allbinjoni

„Çardash“ – V. Monti performancat (violinë dhe orkestër) dhe (bllok flauta dhe piano).



### Detyra

- ♦ Përcaktoni ritmin në kompozimet duke përdoruar shprehje profesionale.




### MËSO MË SHUMË!

Johan Nepomuk Melzl (1771 - 1883) me ndihmën e mekanikut Ditrih Nikolaus Vinkël, krijojnë mekanizëm të veçantë të quajtur METRONOM.

Metronomi ka formën e një piramide, me një mekanizëm të ngjashëm me orën. Zilja në metronom përcakton fillimin e çdo takti. Në pjesën e përparme të piramidës ka një shkallë-tempo të shënuar me numra nga 40 deri në 208. Këta numra tregojnë se sa njësi themelore do të duhet të këndohen në një minutë. Ai rregullohet nga një peshë lëvizëse rrëshqitëse që lëvizën lartë e poshtë në luhatëse metalike.


## Modeli themelor i një metronomi



Nëse pesha rrëshqitëse është në fund të luhatëses metalike, atëherë tempi është më i shpejtë. Nëse peshën rrëshqitëse e lëvizim lart, tempi do të jetë më i ngadaltë .

Me zhvillimin e teknologjisë janë bërë metronome moderne për nevojat e njerëzve dhe muzikës. Sot, ekzistojnë tre lloje të metronomëve: metronomi mekanik (lloji themelor i metronomit), elektronik (digital) dhe metronomi softuerik.

Metronomi softuerik siç është aplikacioni në foto, mund të haset në kompjuterët tuaj nëse dëshironi të punoni me programe muzikore. Sot, metronomët softuerik përdoren në kompjuterët ose në aparatet për inçizimin e muzikës, madje edhe në studiot e filmave për inçizimin e muzikës.



Metronomi elektronik ose digital përdoret si pajisje e veçantë ose si pjesë integrale e instrumenteve elektronike, siç është sintisajzeri.





## GAJDJA



Gajdja është instrument frymor që prodhon dy tinguj të ndryshëm në të njëjtën kohë në lartësi.

Pjesët përbërëse të gajdes janë: **kaceku**, **fyelli i gajdes**, **pipthi** dhe **pipëza**. Shumë emra të tjerë janë të njojur për popullin tonë, por këta janë më të përdorurit.

**Lëkura ose kaceku i gajdes** është pjesa kryesore dhe më e dallueshme pa të cilin instrumenti nuk mund të luajë. Në rajonin tonë më së shpeshti përdoret lëkura e deles dhe e dhisë. Lëkura është e regjur dhe është pothuajse gjithmonë e bardhë dhe madhësia e saj përshtatet sipas nevojave të gjajdistit.

**Fyelli i gajdes** është pjesa më e eksponuar e këtij instrumenti. I njëjti përpunohet prej druri, kryesisht nga: druri i thanës, druri i frashrit dhe i panjës. Ka shtatë vrima në pjesën e përparme dhe një hapje për gishtin e madh në anën e pasme, në fund të tubit është ngjitur një bilbil. Kjo pjesë është e lidhur në qafën e gajdes dhe për lidhje përdoret një bri kau, i cili kontribuon në qëndrueshmërinë, tingullin dhe bukurinë estetike.

**Pipthi** shërben për të fryrë kacekun e gajdes. Është tub i rrumbullakët i bërë në forma të ndryshme, por nga i njëjti dru, ashtu si pjesët e tjera të bëra prej druri. Në vendin ku pipthi hyn në gajde, lidhet me copë lëkure dhe kështu pengohet dalja e ajrit në drejtim të kundërt.

**Pipëza** është pjesë e rëndësishme e zërit që i jep ngjyrën e tingullit të instrumentit. Tingulli për të arritur unitet dhe estetikë, pipëza është bërë nga i njëjtë dru siç janë fyelli i gajdes dhe pipthi. Përbëhet nga tri pjesë që ndahen për dy arsy: për t'u transmetuar më lirshëm dhe mbi të gjitha për të akorduar gajden. Kjo pjesë prodhon një ton të vazhdueshëm (zëri i dytë i gajdes).

### Mënyra e të luajturit në gajde

Para se të fillohet me të luajturit, gajdja mbushet me ajër duke fryrë në pipthin. Pasi kaceku mbushet me ajër, gajdja rregullohet në pjesën e pipëzës duke e përshtatur gjatësinë e saj.

Gajdja mbahet nën dorë (kaceku mbushet me ajër herë pas here). Në fyellin e gajdës luhet me gishtat e të dy duarve.

Pipëza transferohet mbi supe, mbi krahun e djathtë ose mund të varet.

Repertoari i gajdeve përbëhet nga valle dhe këngë popullore të interpretuara gjatë festave të ndryshme.



Pece Atanasovski



**MËSO MË SHUMË!**

Një nga gajdexhinjtë më të njojur në Maqedoni është Pece Atanasovski, i lindur më 25 tetor 1927, në fshatin Dollneni (afër Prilepit).

Gjatë jetës së tij ka luajtur në disa ansamble popullore në: Orkestrën për Instrumente Popullore të Radio-Televizionit Shkup dhe Ansamblin e Valleve Popullore "Tanec". Ai bashkëpunoj me kompozitorin dhe profesorin e etnomuzikologjisë dr. Zhivko Firfov dhe së bashku me të mbajtën seminare verore në Oteshevë në Likenin e Prespës për folklorin, ku morën pjesë dëgjues nga vende të tjera.

Në vitin 1968 në Eriçe të Sicilisë, në një konkurs prej 1800 gajdexhinjve nga e gjithë bota, ai fitoi vendin e parë dhe çmimin "Gajdja e artë".

Vdiq në vitin 1996 të cilin e përkujtojmë si një folklorist dhe muzikant të shquar, i cili kontribuoi në mënyrë të pashtershme për ruajtjen dhe edukimin e shpirtit folklorik të popullit të tij.



## ZURLA



Zurla është një instrument frymor, i cili zakonisht bëhet prej drurit të arrës, por edhe prej drurit të mollës, të kumbullës së zezë dhe panjës.

Zurla përpunohet në dy pjesë dhe atë: tub druri, i zgjeruar në skajin e poshtëm me formë konike, i bërë nga një copë druri dhe sqep, i përforcuar në pjesën e sipërme të tubit.

Zurla ka shtatë vrima melodike në pjesën e përparme, dhe e teta, përgishtin e madh, është vendosur në anën e pasme midis hapjes së gjashtë dhe të shtatë. Në vertikalen, në anën e përparme, ku ndodhen hapjet melodike, janë vendosur tre gabzherrë, si dhe në anën e majtë dhe të djathtë edhe nga një gabzherr.

Pjesa e dytë e zurlës, e quajtur sqepi (bilbili) është bërë nga një copë druri në formën e shkronjës T, në të cilën është formuar kanali(kanelli). Sqepi përbëhet nga koka dhe një tub - kanell. Në anën e përparme dhe të pasme janë prerë dy krahë, të cilat formojnë një elips gjatësor. Pipëza është futur në kanell. Ajo përbëhet nga një tub i shkurtër i lastrës që gjendet në qendër të pllakës qarkore të lastrës.



Në pjesën e sipërme të gypit hyn pipëza dygjuhësore e kallamat të përforcuar në pjesën e poshtme, me skajet e shtypura në formë trapezi. Pipëza te të gjitha llojet e zurlave gjendet nën hapjen e dytë, pra nën hapjen e tretë melodike.

Nën pllakën e lastrës, në gypin e diskut metalik është mbështjellur një pe, i cili ka për detyrë që ta përforcojë diskun metalik dhe njëkohësisht ta mbyll zgavrën. Në të gjitha zurlat gjendet zbukurimi i përbashkët i dy unazave koncentrike të cilat kanë për detyrë të shënojnë gjerësinë e hapjes së pasme melodike. Për të parandaluar tharjen e drurit, muret e brendshme të tubit lyhen me vaj ose ujë, në varësi të llojit të drurit.

Zurla ka tingull karakteristik, shumë të fortë dhe depërtues.

Kombinimi standard është dy zurla dhe dy daulle. Kompozimi i dy zurlave dhe dy dauleve konsiderohet si formacioni më i plotë. Njëri nga zurlaxhinjtë (udhëheqësi) drejton melodinë dhe tjetri e shoqëron atë.

### Mënyra e të luajturit në zurlë

Zurla mbahet me të dyja duart në një kënd prej dyzet e pesë gradë në fushën e shikimit. Gishtat e dorës së majtë vendosen në katër hapjet e poshtme, ndërsa gishtat e dorës së djathtë në hapjet e sipërme, kurse gishti i madh në anën e pasme (hapja për gishtin e madh). Fryrja në grykën e kallamit dygjuhësh sjell ajër në instrument dhe mbyllja e hapjeve me gishtat e dorës së majtë dhe të djathtë jep një ton të ndryshëm. Buzët prekin diskun metalik, i cili ndihmon muskujt e faqeve dhe lehtëson fryrjen në instrument.



Goce Dimovski

#### Detyra

- ♦ Dëgjoni shembuj muzikorë me instrumentet zurlë dhe gjajde dhe diskutoni për ndryshimet dhe ngjashmëritë midis këtyre dy instrumenteve.






## DINAMIKA

Nacioni dinamikë vjen nga fjala greke dynamis që do të thotë forcë. Karakteret dinamike në shënim janë shënuar me shkronjat fillestare të fjalëve italiane.

Dinamika është vëllimi me të cilin këndojmë ose luajmë një kompozim muzikor.



Shenjat për dinamikën janë në gjuhën italiane dhe shkruhen nën pentagramin nën tekstin e shënimit.

### Shembuj për dëgjim (fragmente):

„Bolero“ – M. Ravell

„Koncert për orkestër harqesh“ ( „Palladio“) – K. Xhekins  
„Zile e mbrëmjes“ (për piano) – G. Kolarovski



### Detyra

- ◆ Përcaktoni dinamikën dhe nuancat dinamike në kompozime duke përdorur shprehjet profesionale për dinamikën.



ОВЧАРСКА ПЕСНА / KËNGA E BARIUT  
 (француска народна песна) - канон / (këngë popullore franceze) - kanon



### Овчарска песна

Слатка песна шири свон,  
 овчар весел пее вон.  
 Покрај поток стадо блее  
 среде небо сонце гре.  
 Кавал меден шири глас,  
 лиду, лиду, лиду ду.

Бакал плиска в јужен крај  
 денот топол губи сјај.  
 Весел овчар води в село  
 како облак стадо бело.  
 Кавал нежен шири глас,  
 лиду, лиду, лиду ду.

### Kanon

Kënga e ëmbël zgjeron zile,  
 bariu jashtë i lumtur këndon.  
 Rreth burimit kopeja blegëron  
 mes qiellit ndriçon dielli.  
 Kavalli i ëmbël tingëllon,  
 lidi, lidi, lidi du.

Testia shëndrit në anë të jugut,  
 dita e ngrrohtë e humb shkëqimin.  
 Bariu i lumtur ecën katundit  
 sikur mjegull kopeja e bardhë  
 Kavalli i qetë tingëllon,  
 lidi, lidi, lidi du.

### Yaşasin okulumuz

Daha dün annemizin  
 kollarında yaşarken.  
 Çiçekli bahçemizin  
 yollarında koşarken  
 Şimdi okullu olduk  
 sınıfları doldurduk.  
 Sevinçliyiz hepimiz  
 yaşasin okulumuz.

### RIKUJTOHU!

Kanoni është këndimi i së njëjtës melodi me zëra të shumtë. Fillon zëri i parë dhe kur arrin te numri dy, siç është shënuar në këngën, zëri i dytë fillon ta këndoje të njëjtën melodi që nga fillimi. Notat po ndiqen, por nuk mund të arrihen!



## TAKTI I PËRBËRË 5/8

Takti i pabarabartë është një fenomen ritmik ku rrashjet e taktit nuk mund t'i ndajmë në pjesë të barabarta.

$\begin{array}{ccccccc} \text{+} & \text{5} & \text{ } & \text{ } & \text{ } & \text{ } & \parallel \\ & | & | & | & | & | & \\ 1 & + & 1 & + & 1 & + & 1 = 5 \end{array}$

### PULSIMI

Në taktin 5/8 kemi pulsim të (5) tetësheve në një takt.

### FORMIMI

$(1 + 1 + 1) + (1 + 1) = 5$   
 $3 + 2 = 5$

$(1 + 1) + (1 + 1 + 1) = 5$   
 $2 + 3 = 5$

Në taktin 5/8 formohen dy tërësi ritmike që taktohen me një rrashje, ashtu që në taktin 5/8 në një takt do të kemi dy rrashje. Njëra rrashje, në shembujt, do të jetë më e gjatë, sepse e ndajmë në tre të tetat, ndërsa rrashjen e dytë me dy të tetat. Mund të formohen dy kombinime ritmike, tre të tetat plus dy të tetat nota (3+2) dhe dy të tetat plus tre të tetat nota (2+3).

Shembull nr. 1

### SHËNIMI


Shembull nr. 2

### Detyra

- ♦ Ku është dallimi në mes të shembujve 1 dhe 2, në çfarë janë të njëjtë?



Ushtrimi nr. 1



Ushtrimi nr. 2

“Optan toptan”


1. 2.

Оп - тан      топ - тан      ки - се - ло      мле - ко.      мле - ко.


1. 2.

Кој - ке - го      ја - де      ста - ри - те      ба - би.  
Ста - ри - те      ба - би      што - не - мат      за - би.

Ushtrimi nr 3.



Ushtrimi nr 4.



**Detyra**

♦ Këndoni ushtrimin 2 me nota dhe me tekst.


♦ Taktoni ushtrimet 3 dhe 4, më pas luani ato në instrumentet ritmike të fëmijëve.





## INSTRUMENTET TRADICIONALE PËR FËMIJË NGA E KALUARA

Nga instrumentet e fëmijëve, gjegjësisht grupei i instrumenteve frymore, përdoren lloje të ndryshme borish (bilbilat e shelgut, bilbilat nga lëvorja e pemëve, bilbilat nga pema e drithërave dhe bilbilat nga balta). Nga grupei i instrumenteve me goditje përdoren: çakalle, rrakatakja, pëlcitëse, butoni me fije etj. Instrumentet e goditjes së bariut përdorin zile dhe këmborë të madhësive të ndryshme




### GERRËZA


Gerrëza është instrument i thjeshtë për fëmijë prej druri. Ndërtimi i saj përbëhet nga dërrasa elastike, të cilat rrrotullohen rreth një boshti me dhëmbë. Gjatë goditjes së dërrasave me boshtin prodhohen tingujt.

### ÇAKALLJA

Çakallja është instrument që përdoret në kishat ortodokse në vend të ziles. Tingulli i çakalles fitohet duke goditur një pllakë prej druri ose metali me çekiç ose shkop. Është bërë në forma dhe materiale të ndryshme. Për shkak të thjeshtësisë së këtij instrumenti, fëmijët në të kaluarën e përdornin atë në lojëra të ndryshme për fëmijë.



### KEMANE MISRI




Ky instrument për fëmijë është në fakt, sezonal, sepse kushtëzohet nga periudha në të cilën lulëzon misri. Është bërë nga kërcelli i misrit të freskët ose pak të tharë. Trungut i pritet pjesa ndërmjet kokrrave, më pas në mes priten dy “fije” dhe nën to vendosen dhe dy pemëza.

Është e rendësishme që pemët të mos thahen, sepse atëherë nuk do të arrihet tingulli i dëshiruar. Gjithashtu bëhet edhe një “hark”, kështu që dy pemët e përpunuara gërvishtin njëra-tjetren dhe në atë mënyrë fitohet një tingull që i ngjan një lloj shkarravitjeje, një zë fishkëllimë me lartësi të pacaktuar. Instrumenti përdoret vetëm nga fëmijët si lodër

## LLOJET E ZILEVE

Një nga instrumentet më të vjetra dhe më të zakonshme të goditjes janë zilet. Ato mund të janë në madhësi të ndryshme. Zilja është bërë prej bronzi, hekuri, ari ose argjendi. Toni prodhohet duke goditur trupin e instrumentit të varur nga jashtë, ose duke tërhequr batoqin e ngjitur në brendësi të tij.




## LINGA

Linga është një top i rrumbullakët i zbrazët prej bronzi, në të cilin ka një top, i cili kur tundet e godet pjesën e brendshme të topit dhe kështu prodhon një tingull. Ky top varet në qafën e kuajve dhe kafshëve të tjera.

## BILIA

Bilia është instrument përfshirë fëmijë. Gjatë ndërtimit të saj, fillimisht bëhet pllakë rrëthore, në të cilën thellohet një hapje rrëthore nga njëra anë dhe vendoset fosfor nga një shkrepëse. Një tel ose fije është mbështjellë rrëth pllakës, e cila e mban pllakën të mos fluturojë në rast të goditjeve.



Në skajin e lirë të telit të vogël është vendosur (tërhequr) një gozhdë, me të cilën godet në vrimën e bërë nga fosfori. Me goditjet, fosfori aktivizohet, ndizet dhe shkakton plasaritje. Bilia hasej në viset jugore dhe juglindore të vendit tonë pas Luftës së Parë Botërore.

## FYELLI NGA PRESHI

Fyelli përfshirë fëmijë është i bërë nga kërcelli i preshit. Gishti i madh rrëshqet nën lëkurën e hollë, por në mënyrë të tillë që të mos del jashtë në skajin tjetër, por vetëm në hapjen e duhur midis lëkurës së hollë dhe kores së trashë. Hapja vendoset në buzët dhe duke thithur ajrin përfitohen tone drithëruese të shpendëve.

## RRAKATAKJA

Rrakatakja është bërë nga kërcelli i misrit të njomë. Pjesa e poshtme shërbën si mbështetje dhe pjesa e sipërme pritet në dy ose tre pjesë. Luhet me lëvizje të shpejta dhe të shkurtra të dorës, e cila prodhon një tingull shumë interesant.





## FORMAT MUZIKORE: MOTIVI, FRAZA, FJALIA MUZIKORE DHE PERIUDHA


### TË RIKUJTOHEMI: MOTIVI DHE FRAZA

**Motivi** është tërësia më e vogël ritmiko-melodike.

Motivi duhet të jetë përshtypës, interesant dhe i dallueshëm. Paraqitet shpesh gjatë kompozimit dhe shërben për të ndërtuar tërësi më të mëdha muzikore.

**Fraza** është tërësia më e vogël formale metrike.


Fraza ose dyakti përbëhet nga dy motive dhe e hasim në më shumë fraza në zgjatjen e kompozimit.



**Fjalia muzikore** është mendim muzikor i rrumbullakosur që ka një përfundim apo fund.

Ajo përbëhet nga elemente më të vogla muzikore: motive dhe fraza.

Kemi dy lloje fjalish muzikore: fjali të vogla muzikore të përbëra nga 4 takte dhe fjali të mëdha muzikore të përbëra nga 8 takte.



**Periudha** përbëhet nga dy fjali muzikore që plotësojnë njëra-tjetrën dhe krijojnë një tërësi muzikore të rrumbullakosur. Fjalitë muzikore në periudhën janë të ndërvavarura, fjalia e parë si pyetje dhe fjalia e dytë si përgjigje. Në varësi të fjalive, periudha do të jetë e madhe (e përbërë nga dy fjali të mëdha muzikore) dhe e vogël (e përbërë nga dy fjali të vogla muzikore).

ПРИСПИВНА ПЕСНА / KËNGA E DJEPIT  
Јоханес Брамс / Johannes Brahms

Тив-ка мај - ска крас-на ноќ треп-нат свез - ди

пој, \_\_ ме - сец ja - сен вет-рец благ свон-лив сладок птич - ји

пој. До - бра ноќ до - бар сон се - е тив - ко

вон, слу-шай зов птич- ји пој спиј ми га - ле - бе

мој. Ут - ре га - - ле - бе мој.

*Shembuj për të dëgjuar (fragmente):*

„Kënga e djepit“ – J. Br

„Kënga napolitane“ (periudha e 1-rë) – „Album fëmijësh“, P. I. Çajkovski (performancë korale)



**Detyra**

- ♦ Mësojeni këngën, ndahuni në dy grupe dhe këndoni frazat në mënyrë alternative.
- ♦ Shkruani dy fjali muzikore në fletoren e muzikës me tekst letrar.





## KĒNGA TURKE DHE ROME (ME NOTA)

,Keklik“/„Thëllënzsë“

Këngë popullore turke

Kek - lik      ġim      k1 - na - hı - dir      Kek - lik      ġim

k1 - na - hı - dir      Ka - na - dı      ya - ra - hı - dir

Ka - na - dı      ya - ra - hı - dir      oy      oy.

,,Ava Mancar khel čhaje“/„Eja luaj me mua vajzë“

Muzika: Imer Traja Brizani

A - va,      man - car      khel      čha - je,      a - va,

man - car      khel      tu,      am - a - re      vi - le

tha - bljon      sa - r      duj      me - me - lja.

## KËNGA VLLAHE DHE SERBE (ME NOTA)



„Tsâneam ti cumnicare“ / „Agjërova për të marrë kungimin“

Muzika: Hristo Hristoski -Mular

I - ram nā fea - tā  
ma - re, tsā - neam ti  
cum - ni - ca - re.

„Пролећно јутро у шуми“/„Mëngjesi pranveror në pyll“

Muzika: M.Sokoloviq Ignjaçeviq

На бре - зи се ньи - шу ви - ти ла - ста - ри.  
Про - тр - ча - ла мла - да спр - на про - плин - ком.  
  
Но - вим ли - шћем храст се ки - ти пра - та - ри.  
По - бе - ће - на ноћ је цр - на ос - ван ком.  
  
Зра - ци сун - ца шу - ми - це - лу за - ли - жу.  
  
За - зви - жду - ка кос сад ле - пу а - ри - жу.  
Шум-ских пти - ца за - зво - ни - ше хо - ро - ви,  
и Сун - цу се по - кло - ни - ше бо - ро - ви.

## Të rikujtohemi: shkalla C - dur dhe shkalla a - mol

Shkallë e toneve është një varg melodik me shtatë tone dhe një ton të tetë, të përsëritur, të ndryshëm në lartësi.

**C-dur**

I      II      III      IV      V      VI      VII      VIII  
c1      d1      e1      f1      g1      a1      h1      c2

Vendi i tingujve në shkallën muzikore quhet **GRADË**.  
Ato janë të shënuara me numra romakë.

Distanca në mes dy tingujve të përafërt quhet **SHKALLË**.

Egzistojnë dy lloje të toneve: **TONI** I PLOTË dhe **GJYSËMTONI** .

Çdo shkallë ndahet në dy pjesë të barabarta që do të përbajnjë dy toni i plotë dhe gjysëmtioni. Këto pjesë të shkallës quhen **TETRAKORDE** (*nga greqishtja tetra [katër] kordon [tel]*).

Të gjitha shkallët dur kanë shkallën e tyre molare paralele. Shkallët mol fillojnë nga grada VI në shkallën dur, në mënyrë që grada VI në shkallën dur të bëhet gradë e parë në shkallën e saj mol paralele. Të dyja shkallët kanë të njëjtat tone, por fillojnë me ton të ndryshëm

I      II      III      IV      V      VI      VII      VIII  
c      d      e      f      g      a      h      c

I      II      III      IV      V      VI      VII      VIII  
a      h      c      d      e      f      g      a

a - mol (lloji natyror)

I      II      III      IV      V      VI      VII      VIII  
a      h      c1      d1      e1      f1      g1      a1

## Ushtrimi nr. 1

A musical staff in 2/4 time. It begins with a treble clef, followed by a '2' indicating 2/4 time. The melody consists of eighth notes and sixteenth-note pairs. The first two measures show a descending scale pattern: B, A, G, F. Measures 3-4 show a descending scale pattern: E, D, C, B. Measures 5-6 show a descending scale pattern: G, F, E, D. Measures 7-8 show a descending scale pattern: C, B, A, G.

## Ushtrimi nr. 2

A musical staff in 4/4 time. The first measure contains four eighth notes. The second measure begins with a sixteenth-note grace figure followed by a quarter note, a eighth note, another eighth note, and a sixteenth note.

Ushtrimi nr. 3

## Kënga e vjetër franceze

## Ushtrimi nr. 4

A musical staff in 3/4 time with a treble clef and one sharp in the key signature. It features eight notes: two eighth notes on the fourth line, two eighth notes on the second line, one eighth note on the first space, one quarter note on the third line, one eighth note on the second space, one quarter note on the first line, and one eighth note on the first space.

27



## CAVALLI



Kavalli është instrument popullor frymor i cili përpunohet prej drurit të frashrit, që në mënyrë ornamentike është i pasuruar nëpër tërë gjatësinë e tij.

Mënyra e prodhimit: druri më i përshtatshëm për të bërë kavall është frashri që e kemi në zonën tonë. Zakonisht zgjidhet pema që ishte më e eksposuar ndaj diellit dhe merret një trung nga rrënja deri në majë. Copat e drurit qëndrojnë disa vite për t'u tharë dhe më pas fillon të bëhet kavalli.

Procedura e përpunimit të kavallit është vetëm me metoda tradicionale dhe me një mjet të veçantë dore. Kavalli bëhet në disa dimensione siç janë: 64 cm, 69 cm, 71 cm, 75 cm, 81 cm. Është i hapur nga të dyja anët dhe fundi i sipërm i kavallit është paksa i ngushtuar dhe ka një buzë të mprehtë. Ky instrument ka shtatë hapje për gishtat në pjesën e përparme dhe një për gishtin e madh në anën e pasme.

Hapjet e kavallit janë renditur në mënyrë të barabartë (2cm larg njëratjetrës) dhe hapja e gjashtë është në mes të instrumentit. Përveç tetë hapjeve të përmendura më lart, ekzistojnë katër hapje të tjera të quajtura gabzherrë ose lajmëtarë, të vendosura një në pjesën e përparme dhe një në pjesën e pasme dhe nga një në secilën nga ana e djathtë dhe e majtë. Këto katër hapje quhen akustike sepse prej tyre lëshohet zë jashtë. Pasi të fitohet produkti përfundimtar, është e detyrueshme të vijojë zbukurimi i kavallit nga jashtë, sipas të cilëve kavallisti do të njohe instrumentin e tij.

**Mënyra e ruajtjes së instrumentit:** Për të mbrojtur kavallin nga dëmtimi i tij, ai vendoset në një shkop druri të quajtur arbia. Në fund të krahëve të arbisë, hapen vrima në të cilat futen copa të njomura me vaj. Arbia ka një rol të dyfishtë: të mbrojë kavallin ndërsa leckat e lagura me vaj për t'i mbajtur muret e tij me lagështi.



Shkopi i drurit (arbia)  
Përdoret për mbrojtje edhe të instrumenteve tjera frymore.

Për kavallin ka shumë për të thënë sepse është një nga instrumentet frymore më të vjetra dhe më të përdorura në vendin tonë.

Në të kaluarën, ky instrument luhej shpesh nga barinjtë që të kalonte më shpejt koha kur i çonin delet në kullosa.



### Mënyra e të luajturit në kavall

Gjatë të luajturit, kavalli mbahet me të dy duart, i anuar në anën e majtë për rreth dyzet e pesë gradë në mënyrë vertikale. Gishtat e dorës së majtë mbyllin hapjet melodike të para, të dyta, të treta dhe të katërtë dhe gishti i madh përdoret si mbështetës. Gishtat e dorës së djathtë mbulojnë hapjet e pesta, të gjashta dhe të shtata melodike dhe gishti i madh mbulon hapjen e tetë të vendosur në anën e pasme të kavallit.



Goja mbulon tre të katërtat e hapjes për fyrje të kavallit. Ndryshimi i presionit gjatë fyrjes në instrument e ndryshon edhe lartësinë e tonit. Lartësia varet gjithashtu nga intensiteti i rrymës së ajrit. Kavallistët luajnë me interes të veçantë meloditë e gjera kavalle të njoitura në popull si ezgi, ato ezgi luhën me tonet më të thella, të ashtuquajturat tone kaba.


Tingulli i kavallit është i ngrohtë, melankolik dhe i këndshëm për t'u dëgjuar. Në të kaluarën përdoreshin një palë kavalle me të njëtin ton, njëri prej të cilëve e udhëheq melodinë (udhëheqës) dhe tjetri e shoqëron atë. Pas Luftës së Dytë Botërore, kavallët u përdorën si ansamble melodike në ansamble të ndryshme instrumentale. Sot përdoret në këngët dhe vallet popullore si pjesë e një orkestre ose në performancën solo.







## NGRITËSJA (DIEZI)



Diezi (ngritësja) është simbol muzikor që shkruhet para tonit dhe ndryshon emrin dhe lartësinë e tonit për gjysmë gradë lart.



Kur ngremë një ton, i njëjti e ndryshon emrin, duke shtuar prapashtësën -is. Në këtë rast toni f do të ndryshojë emrin dhe do të quhet fis.



### Detyra

- ♦ Në fletoren e muzikës, sipas emrave alfabetik të toneve që i përdorin njerëzit, shkruani tonet në vendet e tyre në sistemin e pentagramit dhe përdorni saktë shenjën e ngritëses.

## BEKUADRI



Bekuadri është simbol muzikor që shkruhet para tonit dhe e bën kthimin e tingullit në gjendjen e më përparëshme.

A musical staff with a treble clef. It contains two groups of three notes each. The first group consists of a note 'f', a note 'fis' (with a sharp sign), and another note 'f'. The second group consists of a note 'g', a note 'gis' (with a sharp sign), and another note 'g'.

Nëse një ton është ngritur dhe më pas duam ta kthejmë atë në pozicionin e mëparshëm, atëherë përdorim shenjën e bekuadrit.

A musical staff with a treble clef. It contains eight pairs of notes, each pair consisting of a note with a sharp sign followed by a note without it. The notes are labeled as follows: cis, c; dis, d; eis, e; fis, f; gis, g; ais, a; his, h; and cis, c.

Two musical staves, both in common time (indicated by 'c'). The top staff starts with a quarter note 'C'. The bottom staff starts with a quarter note 'F'. Both staves continue with a series of eighth notes.



### Detyra

- ◆ Këndoni ushtrimin.
- ◆ Numëroni sa herë e keni vërejtur re shenjën e bekuadrit në ushtrimin.



## СВИРАМ ВЕСЕЛО (ПО НОТИ) / LUAJ ME GËZIM (ME NOTA)

Muzika: Zvonimir Atanasov


The musical score consists of four staves of music in 4/4 time, treble clef, and G major (indicated by a sharp sign). The lyrics are written below each staff.

Staff 1: Ко - га за - сvi - ram зми - ja o - po фа - ти  
ко во Ин - ди - ja теш - ко да се сфа - ти.

Staff 2: Сви - ram, сви - ram ве - се - ло си - те ми се чу - дат,  
моj - te вер - ни дру - га - ri за гла - ва се др - жат.

Тогаш видоа  
едно јаже бело  
в корпа моткано  
за да биде цело.

Рефрен:  
Свирам, свирам весело...



## KËNGA SHQIPE (ME NOTA)



„Një lule”

Muzika: Çesk Zadeja

**2** Nji lu - le      **3** qi \_\_\_\_\_      **2** m'ka \_\_\_\_\_ çil \_\_\_\_\_ tash      **3** a - man \_\_\_\_\_

**2** mbi githë sho -      **3** qet - - baj - ke      **3** dritë. \_\_\_\_\_

**2** Bu - ku - rinë ma      **3** ke \_ me \_ na - ze \_\_\_\_\_

**2** n'ze - mër ti \_\_\_\_\_      **3** më \_\_\_\_\_ ke zanë vend. \_\_\_\_\_

II

Vaj bre djalë se ç'asht meraku,  
aman, ti hala se ke provu  
Me vu vesh se ç'na thonë hallku,  
kishim vdekë, kishim mbaru.

IV

N'derë t'oborrit mas kapaku,  
aman, ça m'shikon me fytyrë për dhe.  
Me vu vesh se shka thonë hallku,  
ata flasin keq për ne.

III

N'zemër teme ke zanë vend,  
aman, edhe qef s'po m'len me ba.  
Hajde dushe, hajde shpirt  
hajde t'rrina deri n'drit.

V

Edhe mollës na i ra fleta,  
aman, edhe dita na u shkurtu.  
Jalla shokë e t'bajm' sefa-e,  
se gjithmonë s'kena me rrnu.





## FYELLI

Fyelli është instrument frysor popullor i njashëm si kavalli (i hapur në dy anët), mirëpo me gjatësi më të shkurtër. Emri i instrumentit është marrë nga fjala bosh dhe me atë emër është i njojur në viset tona.

Fyelli përpunohet prej drurit të arrës, të thanës, të frashrit apo drurit të panjës. Hapja e sipërme e fyellit shërben për të fryrë dhe quhet gozë ose prerje, ku ka skaje të ngushta dhe të imprehta për ndarjen e ajrit. Përgjatë instrumentit janë të gdhendura (thelluara) gjashtë hapje melodike.

Për të mbrojtur instrumentin nga plasaritja e drurit, në skajin e poshtëm dhe të sipërm të instrumentit vendosen unaza prej materiali brirësh ose mbështillet me tel.

Përgjatë fyellit gjenden disa rrathë koncentrikë dekorativë të vendosur në mes të hapjeve melodike.

Në vendin tonë fyelli është shumë i përhapur, sidomos aty ku është e zhvilluar mbarështimi i deleve.



Mënyra e të luajturit në fyell




Toni prodhohet duke fryrë në hapjen e cila ka skaje të rrumbullakosura (gojzë), në mënyrë që goja ta mbulojë hapjen përrreth 3/4.

Luhet me tre gishtat (të mesëm) e të dyja duarve. Repertori i fyellit përbëhet nga improvizimi i melodive popullore së bashku me instrumente të tjera.

Ngjyra e tingullit të fyellit në tone të ulëta është e butë dhe e këndshme, ndërsa tingulli në tonet e larta është i imprehtë dhe depërtues.

Stefçe Stojkovski

## ZAMARJA DHE KAVALLI I DYFISHTË



Zamarja eshte instrument popullor frymor i cili perpunohet prej drurit te frashrit, te panjës apo ndonjë druri tjeter. Ky instrument ka origjinën në fillimet e krishterimit, ai është i pranishëm dhe i përhapur në vendet e tjera të Ballkanit. Në vendin tonë emrin zamare e ka marrë nga tingulli i tij specifik, i cili nuk është aq i pasur dhe i bukur sa te kavalli.

Ky instrument haset në dy madhësi: 700-780 mm и 240-400 mm (zamarja e vogël) me gjashtë hapje të gdhendura.

Karakteristikë e zamares është ndërtimi i pjesës për të fryrë në instrumentin.

Në pjesën e pasme të pjesës së sipërme pritet një e ashtuquajtur "gjuha". Gjithashtu, në pjesën e sipërme, hapja mbyllitet me një tapë druri (të prerë pak), në mënyrë që ajri të mund të kalojë përmes gjuhës.

### Mënyra e të luajturit në zamare

Gjatë luajtjes instrumenti vendoset vertikalisht para trupit dhe me nga tre gishta (gishtat e mesëm) të dorës së majtë dhe të djathtë mbyllen hapjet dhe fitohen tone të ndryshme sipas lartësisë. Tingulli i zamares është i qartë dhe i këndshëm për t'u dëgjuar.

Të luajturit në zamare është mjaft e lehtë dhe për këtë arsyë është e përhapur në të gjithë vendin dhe përdoret veçanërisht nga barinjtë.

## KAVALLI I DYFISHTË

Është instrument frymor që është një kombinim i dy instrumenteve - njësive, me gjatësi të njëjta, të cilat ngjiten paralelisht, në një copë druri. Secili tub e ka vrimën e vet - një gabzherr dhe një pipëz. Vrimat për të luajtur janë shpuara në atë mënyrë që të ketë katër hapje në njërin tub dhe tre hapje në tjetarin. Ka edhe kavalle të dyfishta ku në njërin tub hapen gjashtë vrima (zakonisht tubi i djathtë), ndërsa në tjetarin nuk ka vrima. Në fyellin e dyfishtë melodia interpretohet në tubin me gjashtë vrima, ndërsa nga tubi tjeter dëgjohet një ton i shtrirë. Fyelli i dyfishtë është një instrument solo i veçantë bariu, përdorimi i të cilit është më i zakonshëm në viset lindore të vendit tonë. Meloditë për këtë instrument janë ritmike dhe melodike, të lira dhe të përshtatshme për kryerjen e improvizimeve.

Fyelli i dyfishtë është instrument prej druri, prej kumbulle, hiri ose akacie, i cili zakonisht stoliset me zbukurime të gdhendura dhe nuansa me ngjyra të ndryshme.






## FORMA DYPJESORE

Tërësitë muzikore: motivet, frazat, fjalitë muzikore dhe periudhat formojnë formën më të vogël muzikore - një formë dypjesëshe. Pjesët e kësaj strukture muzikore janë shënuar me pjesën a dhe pjesën b. Një periudhë është, në fakt, një pjesë dhe dy periudha formojnë formën muzikore dypjesëshe. Pjesët a dhe b mund të jenë të ngjashme ose të ndryshme sipas të dëgjuarit.

Paraqitura skematike e formës dypjesore (ab)



**PERIUDHË pjesë a**

Тив-ка мај - ска крас-на ноќ треп-нат сvez - ди

поj, ме - сец ја - сен вет-рец благ свон-лив сладок птич - ји

поj. До - бра ноќ до - бар сон се е тив - ко

вон, слу-шај зов птич- ји пој спиј ми га - ле - бе

моj. Ут - ре га - - ле - бе моj.

**PERIUDHË pjesë b**

F  
O  
R  
M  
A  
D  
Y  
P  
J  
E  
S  
Ë  
S  
H  
E

Johannes Brahms (1833 - 1897) ishte një kompozitor dhe pianist i famshëm gjerman. Që në moshë të vogël ai ishte i rrethuar nga muzika, sepse babai i tij luante shumë instrumente, por edhe arsimin e parë muzikor e mori prej të atit.

Në klasën e shtatë ka filluar të mësojë të luajturit në piano dhe te profesorët e tij ka pasur disa koncerте. Njohja me Robert Schuman do të ketë një rëndësi të madhe për karrierën e Brahmsit. Ai shkroi komente pozitive për performancat dhe punën e tij.

### **Kujdesi i Brahmsit për të atin**

Babai i Brahmsit nuk kishte një punë të përherershme dhe shpesh mbetej pa para, por kurrë nuk kërkonte prej djalit të tij.



Në një rast, Brahmsi i tha atij:

*Babi, më beso, muzika është ngushëllimi më i madh në çdo situatë.*

Nëse ndonjëherë ndihesh keq, thjesht shfletoje librin e Handelit dhe të garantoj se do të ndihesh më mirë.

Kur babait i mbaruan paratë, atij iu kujtuan fjalët e të birit dhe në librin e kompozitioneve të Handel-it kishte nga një qindarkë në çdo faqe.

"Kënga e djepit" - Johannes Brahms

Ai e shkroi kompozimin për zë të shoqëruar me piano dhe tekstin e mori nga një këngë popullore gjermane. Ky kompozim mund të gjendet edhe në interpretimin e një instrumenti tjeter solo.

**Shembull për dëgjim:**  
„Kënga e djepit“ – J. Brahms (pa refren)



### **Detyra**

- ♦ Përcaktoni fillimin e pjesës b duke ngritur dorën ose letrat.
- ♦ Mësoni këngën, ndahuni në dy grupe, njëri grup këndon pjesën a, ndërsa grupi tjeter këndon pjesën b dhe anasjelltas.





## KËNGA VLLAHE (ME DËGJIM)

„Firmanea di - n Pole“ / „Thirrje për betejë“

Moderato

Muzika: Hristo Hristoski – Mular

A - lea=sh - vi - ne fir - ma - nea,  
fir - ma - nea di-n Po - le  
plän - dza-nj me da - do lea,  
plän - dza-nj me ji - lea=nj - me.  
plän - dza=nj me ji - lea=nj - me.  
2. me ji - lea=nj - me!

2. Firmane din pole  
s-lja gionilji tu ashere.

3. S-lja gionjlji tu aschere,  
aschere nturtsească.

## KĒNGA ROME (ME DĒGJIM)



„Borije“/„Nuse“

Muzika: Imer Traja Brizani

The musical score consists of five staves of music in common time (indicated by '2' over '4') and G clef. The lyrics are written below each staff, corresponding to the musical notes. The lyrics are: La - či je bo - ri - je, la - či je, khel a - men - ge gil - av len - ge, khel a - men - ge gi - lav tu, jekh gili so naj - bu - t men - ge tu. Ši - ngl šan - ge šin, Ši - ngl šan - ge ši - šin, de - fi ba - ša - lel.





## TAMBURA



Tambura është instrument popullor me tela, shfaqja e së cilës në vendin tonë lidhet me pushtimet turke në Ballkan. Ndonëse e sjellë nga turqit, tambura është në fakt një instrument i vjetër mesopotamian.

Tambura zakonisht është prej druri të panjës, blirit, plepit ose dardhës. Tambura përbëhet nga tre pjesë themelore: korpusi ose trupi, qafa dhe koka. Numri i telave mund të jetë 4, 5 ose 6, të rregulluar veçmas ose në çifte.

Në të kaluarën, tamburat bëheshin si një tërësi, vetëm nga një copë druri, ndërsa sot ato bëhen nga tre pjesë që montohen duke i ngjitur pjesët.



Mënyra e të luajturit  
në tamburë

Tambura luhet në pozicion të ulur ose në këmbë dhe me gishtat e dorës së majtë shtypet përgjatë telave ndërsa me dorën e djathtë tërhiqet përgjatë telave. Në traditën instrumentale populllore maqedonase, tambura kishte rolin e instrumentit solo ose si shoqërues i këngëve populllore maqedonase. Më vonë ajo u bë pjesë e ansambleve që përbëheshin nga: gajdja, tambura, daullja dhe kemane si shoqërim i valleve popullore maqedonase.

Sot tamburat janë pjesë e ansambleve më të mëdha që shoqërojnë jo vetëm këngë e valle tradicionale, por edhe valle popullore të stilizuara dhe të kompozuara në kohën tonë. Ngjyra e tingullit të tamburës është metalike dhe kumbuese.

## KEMANEJA



Kemaneja është instrument me tela me formë dardhake ne te cilen janë të shtrira tre tela, fije. Toni fitohet kur me dorën e djathtë me ndihmën e harkut têrhiqet nëpër tela. Gjatësia e instrumentit është rreth 400 – 500 mm.

